

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. _____ Prot,

Tiranë më: ____ 2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SISTEM ME KAMERA, SERVER DHE CHECK IN”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: 35125300-2,48820000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 161 203 (katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e dyqind e tre) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I mbajtur sot më date **31.07.2024**, në DPPGJ – Tiranë, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i thjeshtuar », bazuar në nenin 55 të VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 49 të Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik» me mjete elektronike, **me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontrates mbi sasinë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:**

SASIA E MALLIT

Objekti: “Sistem me kamera, server dhe check in” ne ambjentet I DPPGJ-se

1. SASITE E PARASHIKUARA

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V Kabell FTP cat5	ml	2000
2	F.V Kanalina Plastike 60x40	ml	200
3	F.V Kanaline Plastike 25x25mm	ml	70
4	F.V Tub Rixhid 25Ø	ml	150
5	F.V Kasete e jashtme	Cope	1
6	F.V Kabell 3x2.5mm	ml	200

Sistem Akses Kontrolli			
1	F.V Kabell 2x1	ml	300
2	F.V Kundrabrave Elektrike	cope	10
3	F.V Buton Dalje	cope	10
4	F.V Ushqyes 12V 20AH	Cope	3
Dhoma Teknike			
1	F.V Shpërndarës energjie për rack (PoëerBar min 8 priza)	cope	1
2	F.V Patch Cord 1m	copë	50
3	F.V Patch Cord 2m	copë	20
4	F.V Sistemues Kabllosh 1U	cope	4
5	F.V Patch Panel FTP cat5 24 porta	cope	1
Pajisjet		Njësia	Sasia
1	F.V Kamera te brendshme	cope	7
2	F.V Kamera te jashtme	cope	11
3	F.V NVR 32 Kanale	cope	1
4	F.V HDD 8TB	cope	2
5	F.V Sistem Akses Kontrolli per dyert e institucionit	cope	10
6	F.V Central Telefonik	here	1
7	F.V Switch per Telefonine	cope	2
8	F.V Telefona IP	cope	22
9	F.V Telefon Post Operator	cope	1
10	F.V UPS 2000VA	cope	1
11	F.V Switch 24 porta PoE 10/100Mb	cope	2
12	F.V Switch 8 Porta PoE 10/100Mb	cope	1
13	F.V Workstation menaxhimi	cope	1
14	F.V Monitor 32"	cope	2
15	F.V Akses Point	cope	5

2. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3
1	Faza Përgatitore për sistemin			
2	Lëvrimi i pajisjeve hardëare			
3	Faza e Instalimeve dhe konfigurimeve te pajisjeve dhe sistemeve te monitorimit.			
4	Trajnimi i përdoruesve			
5	Marrja në dorëzim			

LËVRIMI I MALLIT

- Të gjithë artikujt do të sillen brënda **30 ditëve** pas lidhjes së kontratës në magazinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë, ku do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për marrjen në dorëzim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Kërkesat minimale teknike që duhet të plotësohen për pajisjet e ofruara.

KAMERA E JASHTME

Karakteristikat e KAMERAVE	Vlerat specifike
Tipi i kamerës:	Outdoor Bullet
Procesori i Figurës (“Image Sensor”):	Tipi sensorit: CMOS Sensor Madhësia e Sensorit: 1/2.8”
Rezolucioni i Figurës:	Min. 5 Mpx
Ndjeshmëria Minimale ndaj Dritës	Color: 0.0025 lux, F1.6, 0 lux me IR ON
Tipi i Lenteve:	E motorizuar me fokusim automatik
Largësia Fokale (“Lens Type”):	2.8mm -12mm ±10%
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”):	min 50m;
Diapazoni Dinamik i Ndjeshmërisë, Minimumi (Minimum Dynamic Range):	120dB
Rezistenca Ndaj Vandalëve:	IK10
Rezistenca Ndaj Shiut dhe Pluhurit:	IP67
Formati i Kompresimit të Videos:	Kompresim i avancuar H.264 ose H.265 per te ulur nevojat e bandwidthit dhe te storage
Dedektim i Lëvizjes (“Motion Detection”):	Po
Ditë/Natë:	Përshtatje e vërtetë për Ditë/Natë (“True Day/Night: automatic IR cut filter”)

Alarm për rast Sabotimi të Kameras (“Tampering Alarm”):	Po
Pajtueshmëria e Sistemit:	ONVIF
Temperatura e funksionimit:	-30°C deri +55°C
MultiStreaming:	Min. Dual-Streaming
Ushqimi:	PoE (802.3af ose 802.3at)
Aksesorët për montim:	Po, sipas tipit të kamerës dhe mënyrës së montimit
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

KAMERA E BRENDSHME

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi:	Kamera IP e brendshme Dome ose Mini-Dome
Procesori i Figurës (“Image Sensor”):	Tipi sensorit: CMOS Sensor Madhësia e Sensorit: 1/2.7”
Rezolucioni i Figurës:	Min 5.0 Megapixel
Ndjeshmëria Minimale ndaj Dritës:	Color: 0.002 lux at 50 IRE, F2.0 B/W: 0.04 lux at 50 IRE, F2.0 0 lux me IR ON
Tipi i Lentëve (“Lens Type”):	Fikse
Largësia Fokale:	2.8 mm lens ±10%,
Raporti Optik i Zmadhimit (“Optical Zoom Ratio”):	N/A
Ndriçimi Infra të Kuqe (“ IR illuminators”):	Po, me një distancë min. 10m
Rezistenca Ndaj Vandalëve:	IK10
Ditë/Natë:	Përshtatje e vërtetë për Ditë/Natë (“True Day/Night: automatic IR cut filter”).
Diapazoni Dinamik i Ndjeshmërisë, (Minimum Dynamic Range):	Min 90 dB
Formati i Kompresimit të Videos:	Kompresim i avancuar H.264 ose H.265

Dedektimi i lëvizjes “Motion Detection”:	Po
Alarm për sabotimin e kamerës (Tampering Alarm):	Po
Alarme të tjera të cilat aktivizohen duke Analizuar Figurën:	Po (dedektimi i lëvizjes dhe analizim inteligjent video)
Audio:	Po (1 hyrje/1 dalje)
Pajtueshmëria e Sistemit:	ONVIF
Temperatura e funksionimit:	-10°C deri në +40°C
MultiStreaming:	Min. Dual-Streaming
Ushqimi:	PoE ose PoE+ (802.3af ose 802.3at)
Aksesorë montimi:	Po. Sipas tipit të kamerës dhe mënyrës së montimit.
Certifikate konformiteti:	CE
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 vjet

NVR 32 KANELE

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi:	NVR 32 kanale
Nr. Kanaleve:	Min. 32
Memorie Storage:	Min. 8 TB efektive storage me HDD të certifikuar për sisteme vëzhgimi.
Nderfaqja e rrjetit	Min 2 RJ45 10M/100M/1000M
Kompresimi video;	H.265 ose H.264
Faktori i formës “Form Factor”:	1U, i pajisur me aksesorë për montim në rack
Certifikimi i Produktit /Direktiva:	min. CE
Porta USB:	Min. 2 porta USB
Temperaturat e operimit:	-10°C ~ + 50°C
Licensa:	Të përfshira nëse do të jetë e nevojshme
Garancia:	3 Vjet

HDD 8 TB

Hard Disk duhe te jete I certifikuar per sisteme vezhgimi.

SISTEM AKSES KONTROLI

- Sistemi duhet të jetë i aftë për t'u implementuar për një derë të vetme për të monitoruar hyrje-daljet.
- Zgjidhja për sistemin e akses kontrollit duhet të jetë e bazuar në TCP/IP ose RS-485 ose RS-232.
- Sistemi i aksesit të kontrollit duhet të përbëhet minimalisht nga elementet:
 - Një kontrollor i jashtëm ose i inkorporuar.
 - Një lexues kartash aksesi ose gishti
 - Një kundrabrave elektrike.
 - Nje buton dalje (exit buton)
- Kontrolleri duhet të ofrojë të paktën opsione për ndërrim të kartës, shtimin apo heqjen e përdoruesve, etj.
- Te mbeshtesi te pakten teknologjite e kartave Mifare dhe RFID.
- Ekran:Te jete I pajisur me nje ekran min 2.1” per dhenin e mesazheve te ndryshme sinjalizuese
- Të suportojë:
 - Shpejtësia e procesorit: minimalisht 1Ghz.
 - Numri i përdoruesve: min. 1000;
 - Numri i kartave të vlefshme: min. 1000;
 - Numri i ruajtjes së ngjarjeve: min 50 000 log-e;
- Distanca e leximit të kartës: 1 deri 5 cm;
- Temperatura e operimit: -10°C~+55°C.
- Garanci: 1 vit

UPS 2000VA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
DALJE “OUTPUT”	
Tipi "Type":	I montueshem ne Rack
Fuqia “Power”:	2000 VA
Faktori i Fuqisë “Power Factor”:	≥0.7
Forma e Valës “Wave Form”:	Sinusoidale
Tensioni Nominal “Nominal Voltage”:	220 - 240 V AC
Frekuenca “Frequency”:	50 Hz +/- 5%
Rregullimi i Tensionit “Volt, Regul. (On Battery)”:	+/-10%
Prizat Dalëse “Output Connectors”:	≥ (4) IEC 320 C13 (nga bateria)

HYRJE “INPUT”	
Tensioni Nominal “Nominal Voltage”:	220 - 240 V AC
Frekuenca “Frequency”:	50 Hz
Dritarja e Tensionit “Voltage Window”:	170 - 270 V AC
Rregullim Automatik i Tensionit “AVR”:	Po
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Programi i Fikjes “Shutdown Software”:	Po
Sinjalizim me LED “Led Indicators”:	Për të gjitha gjendjet
Sinjalizim me Zë “Audible Indicators”:	Për të gjitha gjendjet
Porta e Komunikimit “ Interface”:	(1) DB9 Serial ose USB
Mbrojtja ”Protection”:	Overload, Discharge, and Overcharge Protection
AKSESORËT	
Kabëll për Linjën Kryesore “Power Cord”:	European
Kabëll për Lidhjen e PC “PC Power Cord”:	(2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14
Kabëll për Komunikimin e të Dhënave “Data Cable”:	(1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB- USB
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

WORKSTATION

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	11500 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”	500 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6.0 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)

“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 vit

SWITCH 8 PORTA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Switch i Pa Menaxhueshëm 8 Porta PoE
Numri i Portave Ethernet, "Number of Ethernet Ports":	8 Porta 10/100
Mënyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward

Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE802.3,IEEE802.3u,IEEE802.3az,IEEE 802.3x, IEEE802.3af,IEEE802.3at
Certifikimi i Produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Lista Tabelave MAC	4K
Packet Buffer	Min 1.6 Mbit
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit

SWITCH 24 PORTA I PAMENAXHUESHEM

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
NDËRFAQET DHE KARAKTERISTIKAT HARDWARE	
Porta 10/100 RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥ 24
Porta Uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots	2 / Combo Opsionale
Instalimi në Rack	19" Rack Mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	100~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Switching Capacity	≥ 8.75 Gbps
Throughput	≥ 6.5 Mpps
Tabelë të Adresave MAC	16k
Packet Buffer	≥ 4 Mbit
STANDARDET	
IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-TX	Po
IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE- TX	Po

AKSES POINT

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Access Point Wi-Fi 6
Standartet WiFi, "WiFi Standards":	IEEE 802.11a/b/g/n/ac/ax

Banda e Operimit, "Band":	Dual Band, min 2x2: 2.4 GHz & 5 GHz
Siguria "Security"	Te pakten WPA2, WPA3.
SSID	Jo me pak se 8
"VLAN Support"	Po
Menaxhimi "Management":	Po
Antenat, "Antennas":	Build-In or External
Portat, "Ports":	Te pakten Gigabit LAN Ports
Menyra e montimit "Mounting method":	Ne mur, ne tavan, ne tavoline (te perfshira aksesoret e montimit)
Drita LED, "LED indicators":	Yes
Ushqimi, "Power Supply":	PoE ose PoE+ (802.3af ose 802.3at) ose 12V DC sipas mënyrës dhe kushteve të montimit.
Garanci:	3 Vjet

MONITOR 32"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Ekрани "Display":	Min. 32", Pamja 16:9 LED
Rezolucioni:	1920 × 1080
Raporti i kontrastit "Constrast Ratio Static":	1200:1 ose më i mirë
"Speakers":	Po, të integruar
Konsumi I energjise	<32 Watt
Porta Hyrese:	HDMI × 1, VGA × 1, Audio × 1
Garanci:	1 vit

INSTALIM I RRJETIT KOMPJUTERIK LAN

Instalimi I rrjetit kompjuterik LAN do te perkoje me kryerjen nga ana e operatorit ekonomik te te gjitha instalimeve kompjuterike per sigurimin e funksionaliteteve te sistemit te kamerave

dhe sistemit te akses kontrollit. Ne tabelen e meposhte do te jepet sasia e perafert e e materialeve dhe pajisjeve te nevojshme per ngritjen e rrjetit LAN.

Tabela 1: Sasia e perafert e materialeve per instalimin e kamereve te brendshme te jashtme dhe akses kontrollit

Pajisjet	Njësia	Sasia
Kabell FTP cat5	Ml	2000
Kanalina Plastike 60x40	ml	200
Kanaline Plastike 25x25mm	ml	70
Tub Rixhid 25Ø	ml	150
Kasete e jashtme	Cope	1
Kabell 3x2.5mm	ml	200
Sistem Akses Kontrolli		
Kabell 2x1	ml	300
Kundrabrave Elektrike	cope	10
Buton Dalje	cope	10
Ushqyes 12V 20AH	Cope	3
Pajisje Dhoma Teknike		
Shpërndarës energjie për rack (PowerBar min 8 priza)	cope	1
Patch Cord 1m	copë	50
Patch Cord 2m	copë	20
Sistemues Kabllosh 1U	cope	4
Patch Panel FTP cat5 24 porta	here	1

Kabell FTP cat5

Kabli I perdorur duhet te jete minimalisht I kategorise FTP cat 5 dhe do te sherbeje per instalimin e sistemit te kamerave ne ambjentet e brendshme dhe te jashtme te godines ,atij te akses kontrollit dhe akses kontrolleve qe do te shperndahen neper godine per mbulimin e plote me WiFi.

Kanalina Plastike 60x40 dhe 25x25

Kanalinat plastike te mbyllura do te sherbejne per kalimin e kabllave LAN ne gjithë ambjentet

e brendshme

Tub Rixhid

Tubi Rixhid do te sherbeje per kalimin e kabllave LAN ne ambjentet e jashtme te godines.

Kaseta e Jashtme

Kaseta e jashtme do te vendoset ne ambjentet e jashtme per tu vendosur Switch 8 Porta I pamenaxhueshem sebashku me nje automat 16A 1P+N per dhenin e energjise dhe nje prize shuko industrial.

Kabell elektrik 3x2.5mm

Kablli elektrik 3x2.5 mm do te instalohet per furnizimin me energji elektrike te Switch 8 porta qe do te instalohet tek kutia e jashtme.

Kabell 2x1

Kablli elektrik 2x1 do te sherbeje per furnizimin me energji elektrike te kundrabravave elektrike.

Buton Dalje

Buton I daljes do te vendoset ne cdo dere per daljen nga zyra. Butoni I daljes dhe kundrabrava jane 10 cope dhe aksesit 10.

Ushqyes 12V 20AH

Ushqyesi 12 V 20AH per furnizimin me energji te kundrabraves dhe aksesit.

Patch Panel RJ45 FTP cat5

Për terminimin e kabllave ethernet në Rack do të montohen patch panele me kapacitet minimal 24 porta, të cilët do të jenë modular për t'u populluar sipas nevojave.

- Tipi: Patch Panel Modular 1U, 19".
- Kapaciteti: Minimumi 24 porta RJ45.
- Lloji i kabllimit që suporton: kabull të skermuar.
- Tokëzimi: Të jetë i pajisur me elementë të cilët sigurojnë tokëzimin e kabllave.
- Etiketimi: Të ketë mundësi për instalimin e etiketave si edhe përdorimin e kodit të ngjyrave.

Patch Corda FTP

Patch cordat duhet të jenë me përmasa 1m dhe 2 m. Patch cordat duhet të jenë të fabrikuara jo të bëra me dorë. Patch Cordat duhet të jenë cat5 FTP. Patch Cord 1m duhen për të bërë lidhjet në Rack nga patch paneli në switch ndërsa patch cord 2m duhet për të bërë lidhjen e pajisjeve ne Rack.

Sistemues kabllosh 1U

Duhet të instalohet menaxhues kabllosh në rack 19", 1U në mënyrë që kabujt të jenë në mënyrë estetike.

CENTRAL TELEFONIK

KARAKTERISTIKAT MINIMALE TEKNIKE	
Lloji I Centralit	IP
Nderfaqja e Internetit	10/100/1000 RJ45
Supporti nga Web	Po
Numri I Userave	Min 40
Komunikime te njokeshme	Min 8
Protokollet e Internet	TCP, UDP, IP, RTP, DHCP, SSH, HTTP, SIP
Opsione	Call waiting, Transferim I thirrjeve, Thirrje ne grup, meeting, Blacklist

SWITCH PER TELEFONINE

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Switch Layer 2 i menaxhueshem 16 Porta PoE/PoE+
Numri i Portave Ethernet, "Number of Ethernet Ports":	16 Porta 10/100
Mënyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward Full duplex
Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE 802.3i 10Base-T IEEE 802.3u 100Base-TX IEEE 802.3X Flow Control IEEE 802.3af/at PoE IEEE 802.1Q static VLAN IEEE 802.1p CoS
Certifikimi i Produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Lista Tabelave MAC	≥45K
Packet Buffer	Min 1.25 Mbit
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit

TELEFON IP

Portat duhet te jene fastethernet 10/100 Mbit, gjithashtu funksionale me PoE. Telefoni duhet te suportoje minimalisht ruajtjen e 500 kontakteve, gjithashtu dhe ruajtjen e minimalisht 600 log-eve per thirrjet e humbura/ hyrese dhe dalese. Te suportroje regjistrimin e thirrjeve ashtu si dhe te kete opsionin Handset/ Handsfree/ Headset. Pajisja duhet te mundesoje bypass te rrjetit LAN dhe lidhjen e PC.. Te jete e mundur ngarkimi I kontakteve ne mase ne telefon.

Telefonat duhet te jene te pajisur me ekran LCD.

Ai duhet te jete I pajisur me minimalisht 24 butona nga te cilet :

12 butona standart

2 butona per uljen dhe ngritjen e zerit

4 butona funksioni lart,poshte, headset, perseritje numri

1 buton “pa ze” mute

4 butona per funksionalite te ndryshme

1 buton

TELEFON POST OPERATOR

Telefoni post operator duhet te kete ekranin kryesor minimalisht ne madhesine 4.3inch LCD qe te jete I lexueshem dhe te jete I pasjisor minimalisht me nje ekran shtese ne madhesine 3.5inch. Per lidhjen e telefonit ne rrjet duhet te jete e disponueshme porta e rrjetit me kapacitet minimalisht 10/100/1000 Mbit me PoE. Ushqimi I telefonit te behet nepermjet PoE ose nje Universal Adapter, nder te tjera konsumi i PoE te jete maksimalisht 4W. Te kete te integruar modalitetin WiFi dhe Bluetooth. Telefoni te jete e mundur te suportoje ruajtjen e minimalisht 2000 kontakteve, gjithashtu keto kontakte te jene te shkarkueshme.

Instalim dhe konfigurim I sistemeve

Kryerja e instalimit dhe konfigurimit te sistemeve ne menyre qe sistemet te jene funksionale dhe te nderveprojne.

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punes i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

Gjithashtu NJP eshte bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve të vecanta teknike me miratimin e titullarit të AK .

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 12.08.2024 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën perkatese të DST –ve, kriterë, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuara nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës ku vlera e xhiros minimale vjetore që u kerkohet operatorëve ekonomike të jetë jo më e vogël **se 40 % e vlerës së parashikuar të kontrates.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjejnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (**2021,2022,2023**) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave te konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesëmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin

kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 261 prot date 02.05.2024 specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në vlerën jo më e vogël se **20 % e vlerës së perlllogaritur të kontrates.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermdura e ben oferten te kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvajtuesit të ngjashme per procedurat e thjeshtuara të jenë ne vlerën jo me e vogel se 20 % të vlerës se **perlllogaritur te kontrates**,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese **certifikaten** e meposhtme;

ISO 9001:2015 Certifikata e sistemit te menaxhimit te cilesise/**ekuivalente**

ISO/IEC 27001:2013 Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacionit/**ekuivalente**

ISO/IEC 20000-1:2018 Certifikata për teknologjinë e informacionit-menaxhimi i shërbimit/**ekuivalente**

Argumentim: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. **2502 Prot., date 09.04.2021**, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 9001:2015 Certifikata e sistemit te menaxhimit te cilesise/ekuivalente siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

ISO/IEC 27001:2013 Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacionit/ekuivalente siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me focus tek siguria.

ISO/IEC 20000-1:2018 Certifikata për teknologjinë e informacionit-menaxhimi i shërbimit/ekuivalente siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të **paraqese autorizim prodhuesi ose nga distributor i autorizuar per territorin e Shqiperise.** Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota si: adresën e saktë të subjektit që e ka leshuar këtë dokument, telefon/e-mail/ëbbsite, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e subjektit, të nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij, për paisjet si më poshtë:

- Kamera e Jashtme
- Kamera e brendshme
- NVR
- Sëitch 8 Porta
- Sëitch 24 porta
- Akses Kontroll
- Central Telefonik
- Sëitch Per Telefonine
- Telefona IP
- Telefon Post Operator
- Akses Point
- UPS 2000VA

Në rast të paraqitjes së autorizimit të distributorit duhet të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre paisjeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave **minimum 10 (dhjete) punonjes** si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) punonjes të certifikuar për menaxhimin e projekteve.
- Minimumi 1 (një) inxhinier elektrik.
- Minimumi 1 (një) punonjes të certifikuar për pajisjet aktive të rrjetit.
- Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për sisteme CCTV.

- Minimumi 2 (dy) punonjës te certifikuar per sisteme akses kontrolli.
- Minimumi 1 (nje) punonjes te certifikuar per central telefonik
- Minimumi 1 (nje) punonjes te certifikuar per rrjetin pasiv data
- Minimumi 1 (nje) punonjes te pajisur me kartela te sigurimit teknik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 5, germa c të vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet.

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e projekteve.

Argumentim: Duke pare qe projekti ka disa lloje sistemesh te cilat do te duhet te implementohen nga ana e operatorit ekonomik do te duhet qe ai te kete minimalisht nje punonjes te certifikuar per menaxhimin e projektit

- 1 (një) inxhinier elektrik.

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure do te behet instalimi dhe konfigurimi i UPS, kryerja e disa instalimeve elektrike do te duhet qe operatori ekonomik te kete te kete 1 (nje) inxhinier elektrik

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisjet aktive te rrjetit.

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure prokurimi do te behet blerja instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve te ndryshme aktive te rrjetit si sëitch , akses point do te duhet qe operatori ekonomik te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisjet aktive te rrjetit.

- 2 (dy) punonjës te certifikuar per sisteme CCTV.

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure prokurimi do te behet blerja instalimi dhe konfigurimi i kamerave do te duhet qe operatori ekonomik te kete minimalisht 2 (dy) punonjes se certifikuar sisteme CCTV.

- 2 (dy) punonjës te certifikuar per sisteme akses kontrolli.

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure prokurimi do te behet blerja instalimi dhe konfigurimi i sistemeve te akses kontroll per te gjitha dyert e institucionit do te duhet qe operatori ekonomik te kete minimum 2 (dy) punonjës te certifikuar per sisteme akses kontrolli.

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per central telefonik

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure prokurimi do te behet blerja instalimi dhe konfigurimi i nje centrali telefonik sebashku me telefonat pkates do te duhet qe operatori ekonomik te kete minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar per central telefonik;

- 1 (nje) punonjes te certifikuar per rrjetin pasiv data

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure prokurimi do te behet blerja instalimi i rrjetit data baker do te duhet qe operatori ekonomik te kete minimalisht nje punonjes te certifikuar per rrjetin pasiv data per percaktimin e tipologjise dhe llojit te rrjetit data.

- 1 (nje) punonjes te pajisur me kartela te sigurimit teknik.

Argumentim: Duke qene se ne kete procedure do te kete disa punime apo instalime elektrike dhe kompjuterike do te jete e nevojshme qe operatori ekonomik te kete pjese te stafit te tij minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar dhe te pajisur me kartela te sigurimit teknik.

Shënim : Nje punonjes mund te disponoje me shume se nje certifikim.

Për çdo punonjës të certifikuar të përfshirë në projekt, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomat dhe Certifikatat përkatëse
- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 025, të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit nga data e fillimit të kësaj procedure.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë shërbim, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për mënyrën e përllogaritjes të vlerës së prokurimit bazuar në nenin 76 të VKM 285 date 19.05.2021.

Sa i përket respektimit të pikës “a”, grupi i Punës ka kontrolluar në faqen zyrtare Institutit të Statistikave (INSTAT), për të marre informacion mbi çmimet për objekt: “Sistem me kamera, server dhe check in” duke specifikuar të dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre artikujve që Autoriteti Kontraktor “DPPGJ” kërkon. INSTAT nuk disponon çmime të botuara për kete lloj procedure.

- *Sa i përket respektimit të pikës “c”, grupi i Punës nuk mund të marrë si shembull cmimet e kontratave të mëparshme të realizuara pasi nuk është realizuar ndonjëherë një shërbim apo blerje e tillë.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje malli, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

- ❖ *Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjes së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të liçensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.*

Grupi i punës ka kontaktuar me këto subjekte që operojnë në treg, për marrjen e ofertave. Format e komunikimit me subjektet e tregut kanë qenë ato të parashikuara në ligj dhe konkretisht me nëpërmjet postës elektronike, në varësi të rrethanave dhe mundësive reale të komunikimit. Subjektet që veprojnë në këtë sektor, janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike të kërkesave tona, për sa i përket, dhe identifikimit të artikujve në treg, në menyrë që këta të fundit të kishin mundësi të analizonin dhe të jepnin ofertat e tyre të përafërta.

Nga sa me sipër grupi i punës ka kontaktuar direkt me operatorët ekonomik duke ju paraqitur kërkesën për ofertë buxhetimi **“Sistem me kamera, server dhe check in”** në përgjigje të kërkesës sonë, pasi janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike dhe kushtet e tjera, sipas të dhenave të dërguara, grupi i punës ka marrë në treg **3** (tre) oferta ekonomike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të

kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës referuar praktikesme miratim të titullarit të AK me Nr.1798/4 prot. dt. 24.07.2024, miratuar nga titullari i AK, bazuar në parashikimet e nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit 162/2020 dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Afati i shërbimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor për 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT;